



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1015/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Merita Zeqiri Hajrizi, kandidate për anëtare të kuvendit komunalë në Lipjan, nga koalicioni (AAK-LDD), paraqitur kundër komisionerëve të koalicionit të (AAK-LDD), për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor dhe manipulimit të votave në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Merita Zeqiri Hajrizi kandidate për anëtare të kuvendit komunalë të koalicionit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Dardanisë (AAK-LDD) në Lipjan.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Merita Zeqiri Hajrizi anëtare nga koalicioni AAK-LDD dega në Rahovec, në të cilën pretendon se me datën 03 Nëntor 2013 është e bindur se i janë keqpërdorur votat e saj në qendrat e vendvotimit QV, Kraishtë – 1305E, Magurë -1302E, Llugagji – 1308E, Banullë 1325E, Topliçan - 1331E, Rufe i Ri -1323E, Janjevë 1303E, Smallushë -1330E, Sillovi – 1317E, Dobrajë e Madhe 1322E, Babush i Muhaxherëve 1306E. Nëpër këto vendvotime janë shkelur dhe keqpërdorur votat e saj, këto shkelje janë bërë nga komisionerët e partisë së tyre duke i marrë votat e saj dhe duke i shkruar për asambleistët e tjerë brenda partisë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse për pretendimet e theksuara në ankesë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullores së PZAP-i lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1015/2013 më datën 06.12.2013

**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24(njëzetekatër) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.